



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 980/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit: NTP “V3-ING”, Vehbi Zejnullahu” B.L., me NRB:70597799 dhe NUI:810889777, me seli në Viti, fshati Ramjan, përfaqësuar sipas autorizimit nga I.Z., kundër debitorit “KAWA Group” SH.P.K., me seli në Veternik, Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga L.V., avokat në Prishtinë, duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorit për kthim në gjendjen të mëparshme të datës 25.07.2022 dhe prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.300/22 të datës 29.03.2022, të Përmbartuesit Privat Kushtrim M. Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 21.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme e paraqitur nga debitori “KAWA Group” SH.P.K., për shkak të mos ruajtjes së afatit për paraqitjen e prapësimin kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.300/22 të datës 29.03.2022, të lëshuar Përmbartuesi Privat nga Kushtrim M. Musa, si e pa afatshme.
- II. HEDHET POSHTË prapësimi i debitorit “KAWA Group” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.300/22, të datës 29.03.2022, të Përmbartuesit Privat Kushtrim M. Musa, si i pa afatshëm.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NTP “V3-ING”, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.300/22 të datës 29.03.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.68 të datës 13.03.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “KAWA Group” SH.P.K, që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 7,000.00 €, me kamatë prej 8% në vit, duke

Ilogaritur prej ditës së lejimit të këtij propozimi për përmba rim e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmba rimore, në të kundërtën përmba rimi të ekzekutohet me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në Ilogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartjen e shumës përkatëse dhe bartja e shumës përkatëse në Ilogarinë bankare të kreditorit, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimit, dhe shitjes së sendeve të luajtshme të debitorit të cilat ndodhen në posedimin e tij deri në vlerën e borxhit.

Debitori me datë 25.07.2022, ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit, me arsyetimin se urdhri për lejimin e përmba rimit nuk është pranuar asnjëherë nga debitori dhe se është njoftuar pasi është vizituar personalisht nga zyrja e përmba ruesit privat për urdhrin për përmba rim. Tutje ka shtuar se nga shkresat e lëndës dhe nga njoftimi i zyrtarëve të zyrës përmba rimore janë njoftuar se zyrja e përmba ruesit privat më datë 05.04.2022, kanë tentuar për të dërguar urdhrin përmba rimor, por nga zyrtarët e postës është kthyer dhe pas këtij tentimi kjo zyre përmba rimore më datë 06.04.2022, ka lëshuar urdhër sipas të cilit urdhri përmba rimor publikohet në tabelën e shpalljeve të përmba ruesit privat dhe është i habitshëm fakti se si kjo zyre përmba rimore e ka gjetur zyrën e debitorit për t'i kontaktuar pasi që urdhri përmba rimor është publikuar në gazetën zyrtare. Ka theksuar se për shkak se zarfi nuk i është dorëzuar debitorit në mënyrë të rregullt dhe se urdhri përmba rimor asnjëherë nuk i ka shkua r debitorit dhe më këtë rast i është pamundësua r ta prapësoj urdhrin, të kishte mundësi të paraqiste fakte të rëndësishme lidhur me kundërshtimet dhe pretendimet e bazuara të tij, brenda afatit të caktua r. Gjykatës i ka propozua r që të lejoj kthimin në gjendjen e mëparshme, të lejohet paraqitja e prapësimi dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarrë nga përmba ruesi privat Kushtrim M. Musa, me seli në Gjilan.

Kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme ia ka bashkëngjitur edhe mjetin juridik të prapësimi, në të cilin ka kundërshtua r urdhrin për lejimin e përmba rimit me arsyetimin se debitori pas pranimit të faturës, që është objekt i këtij shqyrtimi më datë 12.10.2020 ia ka pagua r shumën prej 3,000.00€ kreditorit, për të cilën pagesë debitori ka lëshua r dëftesën e pagesës e cila mbanë nr. 008/2020 dhe përmes të njëjtës formë më datë 12.11.2020, debitori i ka lëshua r dëftesë nr. 011/2020, kreditorit për pagesën në shumë prej 2,000.00 €, duke pagua r shumën ne gjithsej kreditorit prej 5,000.00€. Ka shtua r se urdhri përmba rimor ka të meta dhe si i tillë është i paqarta r pasi që në propozim për përmba rim precizohet se vlera është në shumën prej 5,000.20 €, ndërsa në urdhër është propozua r shuma prej 7,000.00 €, andaj mbi

këtë bazë i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri Përmbarrimor P.nr.300/22 i datës 29.03.2022 i përmbarruesit privat Kushtrim M. Musa, dhe të detyrohet kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e paraqitjes së prapësimi sipas tarifës së OAK-së, në shumë prej 104.00 €, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorit për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimi është e pa afatshme për shkaqet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitorit Urdhri Përmbarrimor P.nr.300/22 i datës 29.03.2022, i lejuar nga Përmbarruesi Privat kushtrim M. Musa, është tentuar të i dorëzohet përmes postës me nr. rekomande R 2215580 me datë 30.03.2022, në adresën: “Rruga e Shkupit” pa numër, Veternik, Prishtinë, e cila figuron në ARBK. Nga fletë kthesa e dorëzuar tek përmbarruesi privat, më datë 05.04.2022, është konstatuar se debitori është e shpërngulur nga kjo adresë.

Përmbarruesi privat me datën 06.04.2022, ka publikuar Propozimin për Përmbarrim dhe Urdhrin për Lejimin e Përmbarrimit P.nr.300/22, të datës 29.03.2022, në tabelën e shpalljeve të përmbarruesit, me njoftimin se pas kalimit të afatit prej 7 ditëve nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve së përmbarruesit, shkresat në fjalë do të konsiderohen se i janë dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit.

Sipas nenit 114 të LPK-së, përcaktohet se: *“Në qoftë se dorëzimi i shkresës subjektivit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t'i bëhet në adresën e treguar në regjistër, komunikimi bëhet duke u ngjitur shkresa në tabelën e shpalljeve të gjykatës, dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës.”*, andaj gjykata vlerëson se në rastin konkret shkresat debitorit përkatësisht propozimi për përmbarrim dhe urdhri për lejimin e përmbarrimit i janë dorëzuar në mënyrë të rregullt.

Me dispozitën ligjore të nenit 130.3 të LPK-së është paraparë se pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimi nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme, ndërsa me dispozitën e nenit 509 është paraparë se në procedurën e zgjidhjes së

kontestëve tregtare vlen afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për paraqitjen e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme nga neni 130 paragrafi 3 i LPK-së.

Andaj duke marrë parasysh faktin se debitori urdhrin përmbarimor e ka pranuar me datë 13.04.2022, ndërsa kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e ka paraqitur me datë 25.07.2022, rezulton se e njëjta është paraqitur pas kalimit të afatit brenda të cilit ka mundur të ushtrohet propozimi dhe nga kjo arsye gjykata vlerësoi se kërkesa për kthimin në gjendje të mëparshme është e pa afatshme.

Meqenëse kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e parashtruar nga debitori rezulton të jetë e pa afatshme dhe marrë parasysh faktin se urdhri përmbarimor është dorëzuar tek debitori me datë 13.04.2022, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 14.04.2022, rezulton se debitori ka pasur afat shtatë (7) ditë që të ushtroj mjetin juridik të prapësimit, në kuptim të nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore me të cilin përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, dhe atë jo më vonë se deri më 20.04.2022.

Andaj pasi që në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 25.07.2022, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me rreth tre muaj (3) e pesë ditë (5) vonesë.

Mbi këtë bazë, e në kuptim të nenit 73, par. 3 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”* gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi duke e hedhur prapësimin si të pa afatshëm.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 129, 130 dhe nenit 131 të LPK-së, e në lidhje me nenin 68.2 të LPP-së, nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par.1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.980/23, datë 21.09.2023

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.